



FTESË PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK NË PROCESIN E PËRGATITJES SË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË KLINËS

Për: Qytetarët e qytetit të së Klinës, personave juridik, shoqatave dhe grupet tjera
Lokacioni: Ndërtesa e Kuvendit Komunal Klinë
Data: 24.05.2018 dhe 25.05.2018
Koha: 11:00

Të nderuar qytetarë të Qytetit të Klinës

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) në bashkëpunim me kompaninë "INSI" nga Prishtina, ka kënaqësinë t'ju ftojë të jeni pjesë e diskutim Publik për sfidat, problemet dhe kufizimet që keni në dokumentet ekzistuese të planifikimit, për ti ndryshuar, plotësuar dhe avancuar gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Klinës.

DUMM kërkon pjesëmarrjen tuaj aktive, që të jeni të informuar mbi përpjekjet e Komunës për të përgatitur Hartën Zonale të Komunës së Klinës, gjatë këtij procesi ne mirëpresim nga ju që të paraqitni propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

DUMM është e përkushtuar të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshme për të kontribuar për përgatitjen e një Harte Zonale të qëndrueshme për Komunën tonë dhe pronat tuaja.

Pjesëmarrja juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke ndikuar dhe kontribuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës në qytetin tuaj.

